



Nr. 1141 Prot.



Tiranë, më 6.09.2023

Drejtuar: Komisionit Qendror të Zgjedhjeve
Rruga "Ibrahim Rrugova", Nr. 4 Tiranë.

Lënda: Kërkesë për regjistrimin në KQZ të koalicionit zgjedhor për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie në Bashkinë Kukës të datës 24.09.2023.

Mbështetur në nenin 65 e vijues të Ligjit Nr. 10019 datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Partia "PARTIA E LIRISË", si parti udhëheqëse e koalicionit, i kërkon Komisionit Qendror të Zgjedhjeve regjistrimin e koalicionit zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14.05.2023

Emri i koalicionit është : "**BASHKË FITOJMË**"
(PL – PDSH – PDK)

Shkronjat nistore të Koalicionit do të jenë: "**BF**"

Sigla e Koalicionit është:



Partitë përbërëse të koalicionit janë:

- Partia e Lirisë;
- Partia Demokratike e Shqipërisë;
- Partia Demokristiane;

Rruga "Sami Frashëri", Godina 20 /10, Tirana - Albania, Tel.: +355 4 450 4178
info@partiaelirise.al, www.partiaelirise.al

Në përputhje me kërkesat e dispozitës së sipërpërmendur të Kodit Zgjedhor, së bashku me kërkesën tonë për regjistrim po ju paraqesim edhe marrëveshjen përkatëse e cila detajon të gjitha elementet e kërkuara nga neni 65 i Kodit Zgjedhor dhe nga Udhëzimin nr. 1 datë 23.12.2020 i KQZ-së.

Përfaqësuesi

Nënkryetari
Endrit Braimllari



Nr. i kopjeve: 3 (tre)

MARRËVESHJE

PËR

KRIJIMIN E KOALICIONIT “BASHKË FITOJMË”

Sot më datë 06.09.2023, ne, partitë politike të mëposhtme:

Po bashkohemi, si parti dhe si qytetarë, jo vetëm për të shmangur rrezikun e eliminimit të pluralizmit dhe pengmarrjen e opozitës, por edhe me qëllimin e lartë për t'i sjellë ndryshimin Shqipërisë, qytetarëve të saj dhe bashkatdhetarëve jashtë vendit.

Ne po bashkohemi si garant i fitores së opozitës dhe forcave euroatlantike në zgjedhjet e ardhshme, për t'i dalë zot Shqipërisë, dhe për të garantuar ndryshimin përmes zgjedhjeve dhe dhënien fund të status quo-së politike dhe abuzimit të pushtetit.

Bashkimi si garant i ndryshimit dhe instrument për forcimin e zërit qytetar opozitar, na bën bashkë dhe më të fortë.

Ne theksojmë nëpërmejt këtij bashkimi të njëjtat vlera e parime në veprimtarinë e përgjithshme politike, si dhe në vizionin për qeverisjen e vendit. Dëshirojmë të koordinojmë angazhimet dhe kontributin për fitoren e përbashkët politike dhe prandaj

VENDOSËM :

1. Të formojmë një Koalicion opozitar, dhe për të konkuruar së bashku në zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie në Bashkinë Kukës, të datës 24.09.2023.
2. Emri i koalicionit është “**BASHKË FITOJMË**”
3. Shkronjat nistore të Koalicionit do të jenë: “**BF**”

Sigla e Koalicionit është:



Drejtuese politike e koalicionit është **Partia Demokratike e Shqipërisë** e përfaqësuar nga organet drejtuese të saj.

Partia udhëheqëse e koalicionit, sipas parashikimeve të nenit 65 e vijues të Kodit Zgjedhor është **Partia e Lirisë**.

4. Të autorizojmë z. Ilir Metaj, Kryetar i Partisë së Lirisë, ose të autorizuarin prej tij, që të paraqesë pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) dhe / ose KZAZ, kandidatët për kryetar bashkie në këtë njësi, si dhe çdo dokumentacion tjetër të nevojshëm për regjistrimin e koalicionit dhe kandidatëve, deri në përfundim të procesit zgjedhor.

5. Të autorizojmë z. Endrit Brahimllari që:

- a. Të paraqesë kërkesë për regjistrimin e Koalicionit, së bashku me këtë marrëveshje, pranë KQZ-së.
- b. Të përfaqësojë Koalicionin gjatë procedurës së shortit, në KQZ, për renditjen e subjekteve zgjedhore në fletën e votimit.
- c. Të caktojë vëzhguesit e Koalicionit në KZAZ-të, KQV-të dhe VNV-të, në të gjithë vendin.
- d. Të përfaqësojë Koalicionin dhe/ose të autorizojë përfaqësues të tjerë, për t'a përfaqësuar atë pranë KQZ, Kolegjit Zgjedhor ose instancave të tjera administrative dhe gjyqësore ku do të konsiderohet e nevojshme. Ai ka të drejtë të nënshkruaj për sa më sipër.

6. Termat konkrete të bashkëpunimit brenda koalicionit do të përcaktohen nëpërmjet marrëveshjeve dypalëshe të partive politike në përbërje të tij.

7. Në listat shumëemërore për këshilltarë të Koalicionit zgjedhor do të përfshihen, për çdo parti të koalicionit, numri i kandidatëve dhe renditja e tyre, bazuar në marrëveshjet midis palëve. Kandidatët në listat shumëemërore të Koalicionit, pavarësisht se cilës parti i përkasin, do të konsiderohen dhe vlerësohen si kandidatë vetëm të Koalicionit, duke shmangur trajtimin e tyre sipas përkatësive partiake.

8. Kjo marrëveshje hyn në fuqi menjëherë ditën e nënshkrimit të saj.

**PARTITË E KOALICIONIT, FIRMËTARE TË KËSAJ MARRËVESHJE,
JANË:**



Partia
Demokratike

PËR

PARTINË DEMOKRATIKE TË SHQIPËRISË

KRYETARI

Sali Berisha



PËR

PARTINË E LIRISË

KRYETARI

Ilir Metaj





PËR

PARTINË DEMOKRISTIANE TË SHQIPËRISË

KRYETARI

Nard Ndoka

